



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 42  
Prishtinë, më 21.06.2019  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Etem Arifi, Valon Ramadani dhe Ali Lajçi.

**Munguan:** Andin Hoti, Verica Qeraniq, Avdullah Hoti dhe Faton Topalli.

**Stafi mbështetës:** Antigona Ibraj, Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Aurel Haxhiu.

**I ftuar:** Faik Demiri, Sabri kadriu dhe Hasan Fejzullahu, përfaqësues të Kompanisë Regjionale “KRM Pastrimi”

**Pjesëmarrësit tjerë:** Ganimete Dalloshi, Fitim Haliti nga ZKA-ja, Marigona Berisha GP LDK dhe Alban Avdiu nga KDI.

**Rendi i Ditës**

- 1: Miratimi i rendit të ditës;**
- 2: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.6.2019,**
- 3: Shqyrtimi i raportit të auditimit të PVF-ve të ndërmarrjes publike “Kompania Regjionale e Mbeturinave Pastrimi SH.A” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**
- 4: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të dala nga raporti i Auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë,**

**5: Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;**

**6: Të ndryshme.**

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.6.2019;**

*Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 7.6.2019, u miratua pa vërejtje.*

**3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të PVF-ve të Ndërmarrjes Publike “Kompania Regjionale e Mbeturinave Pastrimi SH.A” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**

**Driton Selmanaj, kryetar,** bëri të ditur se në mbledhje i pranishëm është përfaqësuesi i KRM Pastrimi, dhe se deputeti raportues rreth auditimit të kompanisë “Pastrimi” është deputeti, z.Mërgim Lushtaku, i cili do të paraqes në mënyrë telegrafike se çka përmban raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

**Mërgim Lushtaku,** tha se ZKA-ja ka dhënë raport të kundërt për “KRM Pastrimi”, për vitin 2018. Pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, si dhe përmbledhjen e proceduarve kontabël, dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas ZKA-së, pasqyrat nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Z. Lushtaku tha se sipas SNK 1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit aktual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka ndërmarrja për të kryer shërbime në të ardhmen, për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht prej ndërmarrjes. Kështu që, në momentin e marrjes së këtyre mjeteve monetare, duke zbatuar parimin e përputhjes së të ardhurave me shpenzimet e kryera për to, ndërmarrja nuk i njeh këto arkëtime si të hyra, pasi shpenzimet për to ende nuk janë kryer. Pra, shtynë njohjen e këtyre të hyrave dhe si pasojë ato do të njihen si detyrime. Arkëtimet në shumën prej 426,076€, nuk u janë zbritur konsumatorëve përkatës për obligimet e paguara ndaj ndërmarrjes, mirëpo këto mjete ishin regjistruar në një llogari me përshkrimin “Klient i panjohur institucione, komuna dhe amvisëri”. Sipas SNK 7, një njësi ekonomike paraqet fluksin e mjeteve të saj monetare nga aktivitetet shfrytëzuese (operative), investuese dhe financuese në mënyrën që është më e përshtatshme për biznesin e saj. Ai tha se vlera e parasë dhe ekuivalentet e saj të paraqitura në Pasqyrën e rrjedhës së parasë në fund të periudhës, ishte mbivlerësuar për 205,110€. Ky keqdeklarim kishte rrjedhur si pasojë e njohjes në këtë kategori të shumës në vlerë prej €28,975, të cilën ndërmarrja e kishte paguar për sigurim të tenderëve, si dhe shumën prej 176,135€, mjete këto të cilat kompania në vitin 2017 i kishte deponuar si garanci në gjykatë për një kontest gjyqësor. Sipas SNK 20, grandet

e marra për aktive të amortizuara njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete. KRM Pastrimi në pasqyrën e të ardhurave kishte paraqitur të hyrat nga grandet në vlerë prej 78,010€, mirëpo, ne nuk ishim në gjendje ta vërtetojmë saktësinë e kësaj shume, pasi që ndërmarrja nuk posedon një listë të aseteve të cilat janë përfituar nga grandet. Ndërmarrja e kishte konsideruar si burim të mjaftueshme për llogaritjen e të hyrave nga grandet vetëm transferin e mjeteve në llogarinë bankare nga ana e donatoreve. Gjatë ekzaminimit fizik të pasurive, është vërejtur që ndërmarrja ka në përdorim 10 automjete të cilat nuk janë të regjistruar në librat kontabël të ndërmarrjes. Sipas konfirmimeve zyrtare nga ndërmarrja, këto asete janë pranuar në vitin 2012 përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si donacion nga Qeveria e Japonisë. Mosregjistrimin e tyre në regjistrat kontabël, ndërmarrja e arsyeton me faktin se certifikatat e regjistrimit të këtyre automjeteve, figurojnë se janë në pronësi të ministrisë. Ndërsa, sipas konfirmimeve zyrtare nga ministria, këto automjete nuk janë të regjistruara në regjistrat e pasurisë të kësaj ministrie. Përveç kësaj, procesit të dhënies në përdorim të këtyre aseteve nuk i kishte paraprirë një dokumentim, ku do të specifikoheshin obligimet dhe të drejtat e të dyja palëve, dhe as një proces formal i pranimit-dorëzimit të këtyre pasurive jo qarkulluese. Mosregjistrimi i këtyre aseteve ndikon në nënvlerësimin e pasurive jo qarkulluese në pasqyrën e pozitës financiare. Sipas SNK 16 pika 50, shuma e amortizuar e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa në pikën 55 të këtij standardi jepen shpjegime se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Për 11 asete, (kryesisht automjete) të cilat ndërmarrja i kishte blerë gjatë vitit 2017 në vlerë totale 130,131€, ndërmarrja nuk kishte aplikuar fare procesin e zhvlerësimit. Sipas konfirmimeve zyrtare ai shtoi se përveç automjeteve në regjistrat kontabël figurojnë vetëm asetet të cilat janë blerë nga ndërmarrja nga viti 2014 e tutje. Ndërkohë që, ndërmarrja ka asete në përdorim të cilat nuk figurojnë në regjistrat e kontabilitetit. KRM Pastrimi nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistratit të aseteve dhe raportit të Komisionit për inventarizim. Për më tepër, deputeti raportues z.Lushtaku shtoi se Komisioni për inventarizim i përcaktuar nga kryeshefi ekzekutiv, më 12.03.2019 kishte dorëzuar raportin e regjistrimit me dokumentet mbështetëse, në të cilin kishin regjistruar vetëm sasinë përkatëse për llojet e aseteve, por pa e identifikuar me ndonjë kod të veçantë secilin aset. Me këto të gjetura, z.Lushtaku përfundoi raportimin për KRM Pastrimi.

**Faik Demiri**, kryesues i Bordit të “KRM Pastrimi”, tha se ne kemi pranuar raportin e auditorit, dhe se të gjitha të gjeturat i kemi pranuar si të sakta, si dhe kemi planifikuar një mënyrë për t’i zgjidhur këto probleme.

**Sabri Kadriu**, tha se kjo është hera e parë që “KRM Pastrimi” është audituar nga ZKA-ja. Ai tha se ata pajtohen me të gjeturat, dhe se janë duke përgatitur për të përmirësuar gjendjen. Sa i përket arkëtimit në avans, ai tha kompania e tij nga 1 janari 2018, Komuna e Prishtinës ka filluar me inkasimin në amvisëri. Ai shtoi se kanë përdorur mjetet e informimit për të përhapur këtë lajm, e që qytetarët kanë vazhduar të kryejnë pagesat, dhe këtë shumë e kanë llogaritur si të hyrë. Por, ai tha se është përgatitur një listë e konsumatorëve të cilët kanë paguar, dhe të cilët do të rimbursohen.

**Sabri Kadriu** tha se ata janë zotuar për përmirësimin e problemeve të shumta, dhe se janë të vetëdijshëm për sfidat që po i presin. Ai shtoi se “KRM Pastrimi” ka pasur një llogari, ku për shkak të mosfrimit të shërbimeve teknike është cilësuar si llogari e klientëve të panjohur, pra të gjitha pagesat kanë rrjedhur nga klientë që ende janë në identifikim e sipër, dhe ai shtoi se pjesë e

programit të tyre si kompani është që deri në vitin 2020, të bëhet rregullimi i këtij problemi. “KRM Pastrimi” ka përgatitur edhe planin e veprimit.

**Kryetari**, tha se ne duhet të konstatojmë se opinioni është ndër më negativët, për KMFP dhe ZKA.

**Ali Lajçi**, tha se po vërehen mjaft mirë problemet dhe qasjet e ekspertizës, ku janë diku rreth 37 rekomandime dhe se këto rekomandime zakonisht bëhen kur mungon përgjegjësia dhe një edukatë menaxhuese. Ai pyeti se deri ku kanë arritur me çështjen e rekomandimeve, për t’i eliminuar ato.

**Faik Demiri**, tha se disa nga rekomandimet janë realizuar menjëherë me emërimin e Bordit të ri, dhe se lista e rekomandimeve është duke u ndjekur hap pas hapi. Ata shpërndajnë mbi 69 mijë fatura në Komunën e Prishtinës, ndërsa në sistem kanë mbi 54 mijë klientë. Ai theksoi se çalojnë në regjistrim për shkak të kompetencave të kufizuara legjislative, por në shërbim qëndrojnë shkëlqyeshëm në regjionin e Prishtinës. Në vitin 2012, një marrëveshje e Qeverisë së Japonisë dhe asaj së Kosovës, me një donacion prej 30 kamionëve, pjesën dërrmuese të tyre e ka marrë Prizreni, dhe 10 “KRM Pastrimi“. Ata janë përpjekur që t’i regjistrojnë si asete, por nuk janë lejuar nga Ministria. Ai shtoi se Ministria përkatëse ka thënë se do të dalë me një vendim të përbashkët me Komunën, dhe pastaj Komuna si aksionare kryesore, do ta bëjë bartjen e tyre, dhe regjistrimin si asete. Ai cilësoi se kjo është si pasojë e legjislacionit, dhe se gjithçka ishte korrekte nga ana e tyre.

**Albert Kinolli**, shtroi një pyetje në lidhje me kontratat e operatorëve ekonomikë të papërgjegjshëm, ku dihet se sipas nenit 65, të Ligjit të Prokurimit Publik, një operator ekonomik nuk ka të drejtë të lidhe një kontratë për ekzekutimin e një kontrate publike nëse ai operator ekonomik këto dy vitet e fundit është shpallur nga një gjykatë kompetente si e falimentuar. Ai po ashtu përmendi edhe disa parregullsi të tjera nga operatorët ekonomikë dhe pyeti cila është përgjigja e “KRM Pastrimi“ për këtë çështje.

**Kryetari**, përmendi edhe dy raste të tjera, sipas mostrës së ZKA-së, rasti i parë është furnizimi me kamionë dhe furnizimi me pjesë elektrike për automjete.

**Faik Demiri** tha se kanë pranuar një përgjigje nga Zyra e kompetencës që ka pasur ZKA-ja. Ai shtoi se kompania e tyre në rekomandimet e dhëna janë të bindur që brenda një periudhe të shkurtër nuk do të ndodhin këto parregullsi dhe për këtë kërkojnë edhe ndihmën e ZKA-së pasi që janë të vetëdijshëm

**ZKA-ja**, përshëndeti të pranishmit dhe fillimisht sa i përket procedurave të prokurimit se në të gjitha rastet kur auditori konstaton gjetjet realizon më pas takime me departamentin përkatës, siguron dëshmi siç janë e-mailet për konfirmim të gjendjes, realizon takimin përmbyllës dhe pas draftit realizon takimin e fundit dhe shteren mundësitë për ekzistencën e dëshmimeve shtesë që dëshmojnë të kundërtën për të hedhur poshtë gjetjet e auditorit, ZKA-ja posedon të gjitha dëshmitë nga konfirmimet zyrtare nga Departamenti i prokurimit dhe KRM Pastrimi, kompania është pajtuar me këto gjetje dhe ekziston letërkonfirmimi nga ana e tyre. Në lidhje me gjetjet e tjera, ka një numër të madh të rekomandimeve, kjo zakonisht tha se ndodh tek të gjitha ndërmarrjet që më herët janë audituar nga kompani private dhe e njëjta ka ndodhur edhe me KRM Pastrimi.

**Mërgim Lushtaku**, theksoi se është parë e nevojshme të përkrahet ZKA-ja që të bëjë një raport për ndërmarrjet publike dhe del se ka pasur nevojë për të parë gjetjet. Po ashtu, pyeti ku qëndron problemi tek klienti i panjohur, ndërsa pyeti përfaqësuesit e ZKA-së, për çështjen e vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë?

**Faik Demiri**, tha se problemi qëndron pasi që përpos shërbimit që ne ofrojmë në disa forme kryhet edhe në formë publike, 10-15 kontejnerë. Problemi qëndron tek banesat kolektive, nuk mund të përdoret asnjë mekanizëm, problem i paidentifikuar është blerja e banesës pasi që nuk regjistrohet

në kadastrë, KRM Pastrimi ka bërë një ulje të numrit të gabimeve sidomos në Komunën e Prishtinës.

**ZKA-ja**, tha se sa i përket aseteve dhe kornizës ligjore, ndërmarrjet publike janë të obliguara që raportimin financiar ta bëjnë në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe gjithashtu në gjetjet e ZKA-së gjithmonë iu janë referuar këtyre standardeve dhe nuk është justifikim mungesa e kornizës ligjore.

**Kryetari**, tha se mosaplikimi i tarifave për shërbimet e ofruara për institucionet është problem tjetër, ku 39 raste që ka identifikuar ZKA-ja, vërehet se i kishte faturuar duke u bazuar në metër katrore e jo siç është përcaktuar me rregullore.

Ai pyeti pse nuk është në përputhje me rregulloren? Ai përmendi edhe tre raste tjera kur KRM Pastrimi, ka bërë pagesa shtesë përkundër ligjit për të ardhurat personale dhe pyeti pse ka ndodhur kjo? Gjithashtu, ndërmarrja ka hartuar një plan të prokurimit prej 32 procedurave me vlerë totale 2.047.179 euro, ku gjatë vitit ishin nënshkruar 88 kontrata, e ku 70 prej tyre nuk janë paraparë në plan të prokurimit, ku qëndron problemi si dhe tek problemi i rekrutimit, ku njerëzit punësohen para se të hapet konkursi?

**Faik Demiri**, tha se kompania ka mbetur mbrapa me interesim dhe rregulloret që kanë qenë në fuqi janë aplikuar, sa i përket metrit katror, ka ndodhur me pajtueshmëri me palën. KRM Pastrimi u tha se është në fazën e fundit të kalimit në zbrazje. Sa i përket pagesave shtesë, KRM Pastrimi ka një numër të madh të punëtorëve dhe se ndonjëherë bëhen pagesa shtesë për ftesa dhe ato nuk lajmërohen, por kjo është ndërprerë. Tek plani i prokurimit pohuan lëshimin që kanë bërë dhe se kanë 133 kamionë dhe pjesa dërmuese janë të vjetër, kur kryhet shërbimi dhe kërkohet afat i caktuar për pajisjet e vjetërsuara, ata gjejnë formë për të aftësuar mjetin dhe për të kryer shërbimin. Sa i përket rekrutimit të stafit nuk dha ndonjë arsye përpos gabimit teknik.

**Kryetari**, pyeti se a është larguar ndonjë person nga puna me gjithë këto lëshime, a ka pasur përgjegjësi?

**Sabri Kadriu**, pohoi se kryeshefi ekzekutiv ka dhënë dorëheqje në tetor deri në zgjedhjen e kryeshefit të ri.

**Emilia Rexhepi**, tha se KRM Pastrimi nuk është e vetmja kompani, e cila ka probleme të tilla. Ka edhe shumë kompani tjera me po të njëjtat çështje, kjo si rrjedhojë e asaj që auditimet e mëparshme nuk janë kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Kryetari**, falenderoi për prezencën e përfaqësuesve të KRM Pastrimi dhe theksoi se për shkak të çështjeve shqetësuese të ndërmarrjes mund të dërgojnë atë në Seancë Plenare.

**Mërgim Lushtaku**, sugjeroi që ky raport të dorëzohet në Seancë.

**Kryetari**, nxori raportin për votim që të dërgohet në Seancë.

### *Përfundim*

*KMFP, vendosi që raporti i Auditimit për Kompaninë Regjionale të Mbeturinave Pastrimi të adresohet për në Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e Komisionit.*

#### **4: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të dala nga raporti i Auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë.**

**Kryetari**, njoftoi deputetët se KMFP në mbledhje e kaluar ka shqyrtuar raportin e auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë. Dhe për këtë ka vendosur për të adresuar për në Seancë Plenare, por administrata ka përgatitur rekomandime të dala për këtë raport nga mbledhja e kaluar të cilat po i lexoj me kusht që të njëjtat të votohen dhe të adresohen së bashku me raportin për në Seancë Plenare. Raporti i Auditimit të Performancës Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë, të shqyrtohet në Seancë Plenare, së bashku me këto rekomandime:

-Me qëllim që Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural tutje (MBPZHR) të punojë në bazë të një plani të analizuar dhe aprovuar nga Qeveria, rekomandojmë MBPZHR-ja që të kërkojë nga Qeveria aprovimin e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për periudhën e mbetur (2019-2020) dhe më pas të ndërmarrë masa që plani për periudhën e ardhshme të aprovohet në kohë.

-Me qëllim që të përfitohen fonde nga BE-ja për sektorin e bujqësisë, rekomandohet që MBPZHR-ja të vendosë struktura që dalin nga kërkesat e instrumenteve për asistencë për anëtarësim në IPARD.

-Me qëllim që të eliminohet dublifikimi i marrëveshjeve për trajnime dhe këshillime të fermerëve për komunat veç e veç, rekomandohet që MBPZHR-ja të respektojë kontratën ekzistuese të nënshkruar për tërë territorin e Kosovës.

-Me qëllim që të arrihen rezultatet e pritshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë me ndihmën e grandeve të dhëna, rekomandohet që MBPZHR-ja të mos tejkalojë kufirin e paradhënies prej 30% (siç është i përcaktuar në legjislacionin e tanishëm në fuqi) të vlerës së mbështetjes për përfituesit, duke obliguar kështu edhe përfituesit të kryejnë investimet e tyre kapitale në projekt.

-Me qëllim që vlera e përdorur për grande t'i plotësojë nevojat e fermerëve dhe bujqve, në njërin anë, dhe të respektohet infrastruktura ligjore dhe kufijtë buxhetor, në anën tjetër, rekomandojmë që në fazën e planifikimit buxhetorë MBPZHR-ja të marrë parasysh nevojat reale të fermerëve dhe në rastet e aprovimit të buxhetit të respektohen kufijtë buxhetor.

-Me qëllim që ndihma financiare t'u jepet fermerëve të merituar, rekomandohet që MBPZHR-ja dhe AZHB-ja të ndërmarrin masa konkrete për përmirësimin e zbatueshmërisë së kritereve të vendosura.

-Me qëllim që të definohet saktë se kush është administrator i sistemit elektronik në AZHB-ja, rekomandohet që me akte të tjera nënligjore të definojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e kryeshefit ekzekutiv dhe drejtorit të TI-së.

-MBPZHR-ja dhe AZHB-ja të zotohen se me fondet të cilat kanë në dispozicion do të mund t'i mbulojnë skemat përfituese të grandeve dhe subvencioneve, me kusht që fermerët të mos kenë vonesa në përfitimin e fondeve të zotuara, pra të ketë kujdes në zgjerimin e skemave të reja përfituese pa pasur një siguri që fondet t'i kenë në dispozicion.

#### *Përfundim*

*KMFP-ja, vendosi që raporti i Auditimit të Performancës, Procesi i Menaxhimit të Grandeve dhe Subvencioneve në sektorin e bujqësisë, të adresohet për në Seancë Plenare së bashku me rekomandimet e Komisionit.*

## **5. Të ndryshme.**

**Kryetari**, njoftoi deputetët se në mbledhje e radhës është vendosur që të diskutohet raporti i Auditimit të PVF-ve për MZHR dhe për ZKM të vitit 2018.

Administrata e komisionit t'i njoftojë përfaqësuesit e MZHR-së dhe të ZKM-së.

Me këtë mbledhja përfundoi.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Driton Selmanaj**